

V E N D I M
Nr.72, datë 11.2.1999

PËR MËNYRËN E LICENCIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË ZYRAVE PRIVATE TË EMIGRIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të ligjit nr.7939, datë 25.5.1995 "Për migracionin", me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Lejimin e veprimtarisë së zyrave private të emigrimit.
2. Zyra private të emigrimit funksionojnë si persona fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, që ofrojnë:
 - këshillime për shtetasit shqiptarë, që synojnë emigrim të përkohshëm apo të përhershëm, personal dhe familjar;
 - shërbime, që lidhen me kërkimin dhe vlerësimin e kushteve të emigrimit në vendet pritëse.
3. Në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale ngrihet komisioni i licencimit të zyrave private të emigrimit, i përbërë nga:
 - Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale(kryetar)
 - Drejtori i Drejtorisë së Migracionit(anëtar)
 - jurist(anëtar)
4. Komisioni i licencimit, pasi bën vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur prej subjekteve të interesuara, vendos licencimin ose jo të tyre.
5. Dokumentet e nevojshme, që duhen paraqitur për licencim, janë:
 - kërkesë me shkrim për licencim;
 - pasaportë (fotokopje e noterizuar), 4 copë fotografi dhe për personat juridikë akti i regjistrimit në gjykatë;
 - dëshmi penaliteti;
 - përshkrimi i veprimtarisë së personit juridik;
 - përshkrim i veprimtarisë që synon zyra private e emigrimit dhe mënyrat e kryerjes së kësaj veprimtarie;
 - autorizim nga autoritetet përkatëse të vendit pritës, në të cilin lejohet personi fizik apo juridik, që të bjëë ndërmjetësimin.
6. Për marrjen e licencës paguhet një tarifë prej 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë.
7. Komisioni mund të mos pranojë licencimin e zyrës private të emigrimit me vendim të argumentuar, në bazë të rrethanave specifike, që mund të krijohen, në mbrojtje të interesave të shtetit dhe të shtetasve shqiptarë.
8. Kundër vendimit të mospranimit mund të bëhet ankim në gjykatë.
9. Zyra private e emigrimit duhet të sigurojë trajtim të barabarë për të gjithë shtetasit, pa dallime raciale, besimi fetar, seksi apo pikëpamjeje politike.
10. Zyra private e emigrimit mund të oforjë shërbime për të miturit vetëm në rast se këta të fundit kanë të dokumentuar, nga zyra e noterisë, leje nga prindërit.
11. Zyra private e emigrimit duhet të njoftojë kandidatët për kushtet ekonomiko-sociale dhe gjeografike të vendit pritës.
12. Zyrat private e emigrimit respekton mirëbesimin e të dhënave të shtetasve aplikues.
13. Zyrat private të emigrimit njoftojnë, një herë në vit, Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale për strukturën dhe veprimtarinë e vet.
14. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale ushtron kontroll mbi veprimtarinë e zyrës

private të emigrimit.

15. Ngarkohen Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Ministria e Financave të nxjerrin udhëzimin për përcaktimin e tarifave të shërbimeve të ofruara nga zyra private e emigrimit.

16. Komisioni i licencimit të zyrës private të emigrimit, kur vëren:

-shkelje të parimit të barazisë;

-publikime të përsëritura, mashtruese;

-shkelje të tarifave të përcaktuara;

-mosrespektim të konfidencialitetit të të dhënave,

me kërkesë të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe të subjekteve të tjera, të interesuara, mund të ndalojë veprimtarinë e zyrës private të emigrimit.

17. Për vendimin e komisionit të licencimit mund të bëhet ankim në gjykatë.

18. Ngarkohet Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale të nxjerrë udhëzimin në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko